REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINA- SUVA REKA

Drejtoria e Arsimit
05 nr. 111-65207
Datë 04.10.2023

Në bazë të nenit 81 të Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197,Kapitulli V neni 67 dhe 68,Ligjit nr.04/l-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr.151/2020 për Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit në Republikën e Kosovës,Procedurat e zgjedhjes dhe emërtimit,përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria e Arsimit shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të lirë të punës

Titulli i vendit të punës: Drejtor në SHFMU " Migjeni " në Gjinoc

Lloji i pozitës: Jo i karrierës
Numri i Pozitave: një (1)
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Drejtorisë për Arsim
Grada/Koeficienti:- E14-6.2
Orët e punës: 40
Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vite.

Qëllimi i vendit të punës:
Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo arsimore.

Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit në IEAAP:
Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësi ekzekutive në menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit, duke përfshirë:

- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me nxënësit ,mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë të arsimit;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlidhura të praktikës;
- Kujdeset për sigurinë e nxënësve dhe të mësimdhënësve dhe harton planin e veprimit për parandalimin e dhunës në shkollë
- Monitorimin(hospitimin)e orëve mësimore me formular përkatës të monitorimit(procesverbal me rekomandime).
- Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimin sipas kërkesave të KDSH-së dhe detyrat lidhura me kurrikulimin .
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave,siç parashihet nga Komuna apo Ministria.
- Qështje tjera që rregullohen permes ligjit për arsimin parauniversitar,akteve nënligjore të miratuara nga MASHT dhe obligimet që dalin nga rregullorja e komunës për arsim.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit;

  1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 300 ECTS, sëpaku 5 vite të shkollimit universitar);
  2.Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
  3.Katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar);
  4.Bachelor katërvjecar (kualifikimi prej 240 ECTS, së paku 4 vite të shkollimit universitar);

- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve,
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akreditуar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit të KSHL;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukativo – arsimor sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës;
- Pesë (5) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për arsimin e mesëm të lartë;
- Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët e niveleve tjera;
- Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor.

Dokumentet e nevojshme:

- ✓ Diploma e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- ✓ Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë;
- ✓ Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të Certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e Diplomës Master në këtë fushë të studimeve;
- ✓ Kopja e dokumentit të identitetit(ID)
- ✓ Ekstraktin e lindjes
- ✓ Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor i licencuar me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- ✓ Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijë fëmijët;
- ✓ Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- ✓ Deklaratën nën betim që vërteton se në tri vitet e fundit nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- ✓ Portofolin profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA.

-Kandidati/ja për të përgatitur planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor ka të drejtë të ketë qasje të plotë në planin zhvillimor aktual në institucionin në të cilin aplikon.

Konkursi është i hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga data 04.11.2023 deri më datë 18.11.2023

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren nr.1 në Komunën e Suharekës.
Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e pakompletuara refuzohen.
Të gjitha dokumentet të dorëzohen në kopje (dokumentacioni nuk kthehet).

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Republikës së Kosovës si dhe në kolegjet private brenda Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto pozita, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kushtë të konkursit.

Rezultatet shpallen në linkun: https://kk.rks-gov.net/Suharekë dhe https://konkursi.rks-gov.net/

Drejtori i DKA-së
Remzi Bajselmani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
MUNICIPALITY SUHAREKË
OPSTINA- SUVA REKA

Direkcija za Obrazovanje
05-Br.111-65207
Datum 04.10..2023

U skladu sa Zakonom o javnim službenicima br. 08 / L-197, poglavlje V, članovima 67 i 68, člana 5 (slovo d) Zakona 03 / L-068 o obrazovanju u opštinama Republike Kosova, člana 34. Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova 04 / L-032,kao i u skladu sa Administrativnim uputstvom br. 151/2020, o Zadacima i odgovornosti direktora i zamenika direktora javne preduniveristetske edukativno-obrazovne i osposbvljavajuce institucije u Republici Kosova, procedure izbora i imenovanja, zavrsetak ugovora i privremeno imenovanje, Opštinska direkcija za obrazovanje u Suva reku, objavljuje:

KONKURS
Za popunjenje slobodnih radnih mesta

Naziv radnog mesta: Direktor OSNŠ " Migjeni " Ginovce

Vrsta pozicije: Ne karijeri
Broj pozicija: Jedan (1)
Naziv nadzornog: Direktor obrazovanja
Koeficijent - 7.8
Radni sati: 40
Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine

Svrha radnog mesta
Upravljanje, organizacija i nadzor obrazovnog procesa u edukativnoj-obrazovnoj ustanovi.

Dužnosti i odgovornosti za direktora :

- Direktor obrazovne institucije ima izvršne odgovornosti u celokupnom menadžmentu i administraciji institucije, uključujući:
- Dužnosti za izbor, ocenjivanje, disciplinu i druga pitanja koja se odnose na učenike, nastavnike i druge obrazovne radnike;
- Efikasno i delotvorno korišćenje informacija o upravljanju obrazovanjem i poštovanje povezanih kodova prakse;
- Stara se o sigurnosti učenika i nastavnika i izrađuje akcioni plan za prevenciju nasilja u školi
- Praćenje (hospitacija) časova nastave sa odgovarajućim monitoringom (zapisnik sa preporukama).
- Planiranje i upravljanje školskim budžetom u skladu sa zahtevima KDŠ i nastavni plan i program
- Čuvanje dokumenata i podataka, kako to predviđa Opština ili Ministarstvo. Obavlja druge poslove po naređenju Direkcije ODO
- Ostala pitanja regulisana ovim zakonom i obaveze koje proizilaze iz opštinske uredbe o obrazovanju.

Uslovi:

- Da budu državljani Republike Kosovo,
- Završili univerzitetsko obrazovanje;

-Master iz rukovođenja, administracije ili upravljanja u obrazovanju (kvalifikacija 300 ESPB,najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
-Obrazovni master (kvalifikacija 300 ESPB, najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
-Četiri godine (kvalifikacija 240 ESPB, najmanje 4 godine univerzitetskog obrazovanja);
-Četvorogodišnji prvostupnik (kvalifikacija 240 ESPB, najmanje 4 godine univerzitetskogobrazovanja);

- Imati redovnu nastavničku licencu u skladu sa uputstvom za licenciranje nastavnika,
- Uspešno završili akreditovani program profesionalnih kvalifikacija za liderstvo, administraciju ili menadžment u obrazovanju koji je odobrio MPN, prema preporuci SCT.
- 1.Pet(5)godine radnog iskustvo u obrazovanom procesu za kandidate za direktora u srednjem obrazovanju,
- 2.Četiri(4) godina radnog iskustva u obrazovanom procesu za kandidate na drugim novima,
- 3.Tri (3)godine radnog iskustva u obrazovanom procesu za kandidate za zamenika direktora.

Potrebni dokumenti:

- ✓ Diploma fakulteta završena za odgovarajući nivo;
- ✓ Uverenje o uspešnom završetku programa obuke za liderstvo, administraciju ili upravljanjeu obrazovanju, zasnovan na standardima profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu;
- ✓ Kandidat koji je završio univerzitetski master program iz liderstva, administracije ili menadžmenta u obrazovanju, u nedostatku Uverenja o obuci za obrazovanje lidera, pruža dokaz o magistarskom stepenu iz ove oblasti studija;
- ✓ Kopija ličnog dokumenta,
- ✓ Ekstrakt rođenja,
- ✓ Zdravstveno uverenje izdato od strane licencirane zdravstvene ustanove koje dokazuje njegovo / njeno zdravstveno stanje;
- ✓ Dokazi da nije pod istragom i dokazi da nije osuđivan za krivično delo, nasilje ili prekršaj koji je uključivao decu;
- ✓ Dokaz o radnom iskustvu u obrazovnom procesu;
- ✓ Izjava pod zakletvomkoji dokazuje da u poslednje tri godine nisam bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija;
- ✓ Professional portfolio sa dokazima u skladu sa uputstvima u formulari H/ovog AU.

- Kandidat za izradu razvojnog plana obrazovne ustanove ima pravo na puni pristup aktuelnom razvojnom planu u ustanovi na koju se prijavljuje.

Konkurs je otvoren 15 dana od 04.11.2023 do 18.11.2023

Prijave se primaju i predaju u Prijemnu Kancelariju u Opštini Suva Reka.Na razgovor će biti pozvani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume i uđu u uži izbor. Prijave predate nakon isteka roka neće biti prihvaćene, dok će nepotpune prijave biti odbačene.

Svi dokumenti moraju se predati u kopiji (dokumentacija se ne vraća).

Svi kandidati koji su završili studije van Republike Kosovo, kao i na privatnim koledžima u okviru Republike Kosovo i koji se prijavljuju za ove pozicije, moraju imati nostrifikovane diplome (stečene univerzitetske diplome) od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije u skladu sa Administrativnim uputstvom, br.12 / 2018 od 10.09.2018, u protivnom će komisija tokom izbora prijava odbiti svaku prijavu kandidata koji nisu ispunili ovaj uslov konkursa.

Rezultati su objavljeni na linku: https://kk.rks-gov.net/Suvareka i https://konkursi.rks-gov.net/.

Direktor ODO-a
Remzi Bajselmani